



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Mars 2021

Nr. 140

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Vorë

Kërkues: Lëvizja Socialiste për Integrim

Ndaj: Bashkia Vorë
Kryetari në detyrë z. Gentian Picari

Baza ligjore: Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim me shkrim, administruar pranë KQZ me shkresën nr 1185 prot, datë 15.02.2021, nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo



institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit të datës 11.02.2021, protokolluar me shkresën 1185 prot., datë 15.02.2021 pranë KQZ, të kallëzuesit LSI, pretendohet se: *“Nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Vorë, rezulton se kjo Bashki nuk ka një të tillë. Referuar parashikimeve në nenin 79, pika 1 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar dhe në nenin 7 pika 1 shkronja “c” të Vendimit nr.9/2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Bashkitë duhet të përmbushin detyrimin për hapjen e faqes zyrtare me qëllim publikimin e detyrueshëm të parashikimeve të dispozitave të sipërcituara. Në këto kushte kërkohet ndërrmarja e hapave konkrete me qëllim që Bashkia Vorë të plotësojë këtë detyrim ligjor”.*

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Nga verifikimet paraprake të administratës në lidhje me ekzistencën ose jo të kësaj faqe ne ueb, rezultoi një link bashkiavore.gov.al/sq-al/Pages/default.aspx, por pa mundësi aksesi të mëtejshëm.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi LSI përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Neni 79 pika 1, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton se *“Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit”.*

Neni 7, pika 1, germa “c” e Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ përcakton se *“Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë,*



kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit, me qëllim administrimin e çdo denoncimi dhe të çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit, shantazhimit apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të atij institucioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo të kandidati në zgjedhje”.

Duke qenë se denoncimi me kërkesën e hapjes së faqes së internetit nga ana e Bashkisë Vorë në mënyrë që të gjejë zbatim neni 79, pika 1 i Kodit Zgjedhor dhe neni 7, paragrafi 1, shkronja “c” i vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se Bashkia Vorë është subjekt i zbatimit të ligjit 10019 datë 29.12.2008 dhe vendimit 9/2020 të KQZ-së.

II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9/2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Më datë 15.02.2021 është raportuar kallëzimi për Bashkinë Vorë, protokolluar me shkresën Nr.1185 prot., datë 15.02.2021, në të cilin pretendohet pretendohet se: *“Nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Vorë, rezulton se kjo Bashki nuk ka një të tillë. Referuar parashikimeve në nenin 79, pika 1 i Kodit Zgjedhor të ndryshuar dhe në nenin 7 pika 1 germa “c” të Vendimit nr.9/2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Bashkitë duhet të përmbushin detyrimin për hapjen e faqes zyrtare me qëllim publikimin e detyrueshëm të*



parashikimeve të dispozitave të sipërcituara. Në këto kushte kërkohet ndërmarrja e hapave konkrete me qëllim që Bashkia Vorë të plotësojë këtë detyrim ligjor.

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1294 prot., datë 18.02.2021, i ka kërkuar informacion Kryetarit të Bashkisë Vorë për masat e marra nga ana e tyre për plotësimin e kërkesave të parashikuara nga neni 79 pika 1 e Kodit Zgjedhor si dhe nenit 7, pika 1 shkronja “c” të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Me shkresën nr. 1466/1 prot., datë 03.03.2021, administruar pranë KQZ-së me shkresën nr.1294/1 prot., datë 08.03.2021, jemi informuar se Bashkia Vorë ka një domain ekzistues të institucionit por ka humbur aksesin për përdorimin e tij. Nga shkresa rezulton e provuar se, Bashkia Vorë ka komunikuar nëpërmjet postës elektronike me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si dhe IKUB, të cilat mirëmbajnë faqen zyrtare të Bashkisë Vorë, për të rimarrë faqen e institucionit në përdorim.

III

Analiza juridike dhe konkluzione

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se Bashkia Vorë nuk ka një faqe aktive interneti ku subjektet zgjedhore dhe publiku mund të marrin informacionin e nevojshëm sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor.

Referuar neni 7, pika 1, germa “c” e Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së përcakton se *“Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit, me qëllim administrimin e çdo denoncimi dhe të çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit, shantazhimit apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të atij institucioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo të kandidati në zgjedhje”*. Referuar këtij vendimi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se kjo dispozitë nuk është zbatuar nga Bashkia Vorë.

Referuar nenit 79 pika 1, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton se *“Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë*



në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit”.

Për sa më sipër, me qëllim zbatimin e nenit 79, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 7, pika 1, germa” c”, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator me qëllim administrimin e çdo denoncimi dhe të çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit, shantazhimit apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të atij institucioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo të kandidati në zgjedhje dhe marrjes së informacionit për vendet ku do të afishohen materialet propagandistike për fushatën zgjedhore, Bashkia Vorë duhet të marrë masat e menjëhershme që t’i përmbahet afatit të përcaktuar në nenin 79, pika 1 e Kodit Zgjedhor, për rihapjen e faqes së internetit.

Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor parashikohet se *“shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”.*

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator të KQZ, nuk ka kompetenca për të vendosur sanksione për mos hapjen e faqes së internetit nga Bashkia Vorë, por në kuptim të nenit 79, pika 1 të Kodit Zgjedhor, mosmarrja e masave të nevojshme brenda afateve të parashikuara për publikimin e vendimeve të Bashkisë Vorë për caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike, ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vorë , si subjekt i ngarkuar për zbatimin e këtij ligji.

Nëse Kryetari i Bashkisë Vorë, nuk do të përmbushë detyrimin ligjor që buron nga neni 79, Komisioneri do të marrë sanksione me qëllim garantimin e zbatimit të Kodit Zgjedhor. Në kohën e shqyrtimit të këtij denoncimi Komisioneri nuk mund të marrë sanksion për një kundërvajtje që mund të ndodhë hipotetikisht.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe



vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Kryetari i Bashkisë Vorë të marrë masat e menjëhershme për aksesimin e faqes së internetit për zbatimin e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga njoftimi i tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
E.Meta _____
M.Koja _____
Y.Merkaj _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

